



INSTITUTI ALBANOLOGJIK - PRISHTINË

Numri në dorëdhën: 01.10.2025

Ij. Dp.	Numri	Shtojcë	Vlera
IAP	30/2		

INSTITUTI ALBANOLOGJIK - PRISHTINË

Në bazë të nenit 23 të Ligjit nr. 04-L/135 për Veprimtarinë Kërkimore Shkencore, si dhe në bazë të nenit 23, pika 7.1, nenit 24 dhe 25 të Statutit të Institutit Albanologjik, Këshilli Drejtues i Institutit, në mbledhjen e mbajtur më 01.10.2025, miratoi:

RREGULLOREN E PUNËS SË KËSHILLIT SHKENCOR TË INSTITUTIT ALBANOLOGJIK

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Këshillit Shkencor të Institutit Albanologjik si organ kolegjal, përfshirë: kompetencat, thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjeve, mënyrën e vendimmarrjes dhe zbatimin e vendimeve, si dhe çështje të tjera përkatëse.

Neni 2

Kompetenca të Këshillit Shkencor

Këshilli Shkencor i Institutit Albanologjik është organ shkencor-profesional dhe vendimmarrës në sferën shkencore dhe profesionale.

Këshilli Shkencor:

1. Shqyrton dhe vendos për çështjet shkencore dhe profesionale.
2. Propozon kandidatët për drejtor të Institutit.
3. Propozon kandidatin për u.d. të drejtorit të Institutit.
4. Cakton komisionet dhe zhvillon procedurat për përzgjedhjen në tituj shkencorë dhe hulumtues.
5. Shqyrton dhe propozon planin e punës kërkimore-shkencore dhe të veprimtarisë botuese të Institutit Albanologjik.
6. Shqyrton raportin e punës kërkimore-shkencore të Institutit Albanologjik.
7. Zgjedh anëtarët e Këshillit Drejtues, nga radhët e shefave të degëve.
8. Propozon sekretarin shkencor të Institutit.
9. Në bazë të propozimeve të degëve, zgjedh kryeredaktorët dhe anëtarët e redaksive të revistave dhe të botimeve të veçanta të Institutit.

10. Në bazë të propozimeve të degëve, merr vendimin për shpalljen e konkursit për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e punonjësve shkencorë dhe të hulumtuesve.
11. Kujdeset për aftësimin e kuadrit shkencor dhe profesional.
12. Vendos edhe për çështje të tjera që, për nga rëndësia e tyre profesionale dhe shkencore, duhet të shqyrtohen nga Këshilli Shkencor.
13. Këshilli Shkencor përbëhet nga të gjithë punonjësit shkencorë të Institutit që mbajnë tituj shkencorë, së paku bashkëpunëtor shkencor.
14. Anëtarët e zgjedhur në Këshillin Drejtues marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Shkencor, por nuk kanë të drejtë vote për çështjet që vendosen në Këshillin Drejtues.

Neni 3

Punët e Këshillit Shkencor

1. Këshilli Shkencor si organ kolegjal ushtron veprimtarinë e tij përmes mbledhjeve dhe komisioneve, në të cilat duhet të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.
2. Këshilli Shkencor shqyrton referatat e komisioneve për zgjedhjen, rizgjedhjen dhe avancimin e personelit shkencor.
3. Vendimet e Këshillit Shkencor merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
4. Mbledhjet e Këshillit Shkencor thirren dhe kryesohen nga drejtori i Institutit Albanologjik.
5. Në rastet kur drejtori, për arsye të justifikuara, nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, ose kur në rend dite përfshihen çështje që paraqesin konflikt interesi, mbledhja drejtohet nga sekretari shkencor i Institutit.
6. Për çdo mbledhje të Këshillit Shkencor mbahet procesverbal, i cili përgatitet dhe nënshkruhet nga sekretari shkencor i Institutit.
7. Në rast se sekretari shkencor ushtron funksionin e kryesuesit të mbledhjes, me propozimin e
8. tij dhe miratimin e anëtarëve të pranishëm në Këshillin Shkencor, procesverbalin e mban njëri nga anëtarët e Këshillit.

Neni 4

Kryesuesi i Këshillit Shkencor

1. Kryesuesi i Këshillit Shkencor, në përputhje me legjislacionin në fuqi, është drejtori i Institutit.
2. Në rast se, për arsye të justifikuara, kryesuesi nuk mund të marrë pjesë në mbledhje ose kur në rendin e ditës shqyrtohen çështje që paraqesin konflikt interesi, mbledhjen e Këshillit Shkencor e kryeson sekretari shkencor i Institutit.

Neni 5

Mbledhjet e Këshillit Shkencor

1. Mbledhjet e Këshillit Shkencor thirren dhe kryesohen nga kryesuesi i Këshillit Shkencor.
2. Në mungesë të kryesuesit, mbledhjen e thirrë dhe e kryeson sekretari shkencor i Institutit.
3. Në rast se mungojnë si kryesuesi ashtu edhe sekretari shkencor, mbledhja mund të thirret nga të paktën një e treta (1/3) e anëtarëve me të drejtë vote. Këtë mbledhje e hap nënshkruesi i parë i kërkesës për thirrjen e saj, sipas listës së anëtarëve nënshkrues. Pas hapjes, propozohet dhe zgjidhet për kryesues njëri nga anëtarët e Këshillit Shkencor me të drejtë vote.
4. Mbledhjet thirren sipas nevojës nga kryesuesi i Këshillit Shkencor.
5. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren në çdo kohë, sipas procedurave të parapara. Rendi i ditës i këtyre mbledhjeve duhet të kufizohet vetëm në një pikë kryesore. Gjatë zhvillimit të mbledhjes, Këshilli Shkencor mund të vendosë për thirrjen e një mbledhjeje të ardhshme. Në këto raste, ftesat u dërgohen të gjithë anëtarëve të Këshillit, të paktën 48 orë para mbledhjes.
6. Anëtarët e Këshillit Shkencor duhet të ftohen të paktën 48 orë para mbledhjes. Ftesat duhet të dërgohen me shkrim, përmes postës elektronike (e-mail) ose në çfarëdo forme tjetër teknike që garanton dërgimin e informacionit.
7. Mbledhja e Këshillit Shkencor është e vlefshme nëse të gjithë anëtarët janë njoftuar të paktën 48 orë para mbledhjes dhe nëse marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.
8. Kryesuesi ka të drejtë në ftojë në çdo kohë ekspertë për çështje të caktuara, sipas nevojës.
9. Kryesuesi është i obliguar të thërrasë mbledhjen e Këshillit Shkencor nëse këtë e kërkojnë së paku një e treta (1/3) e anëtarëve të Këshillit, dhe nëse kërkesa është e arsyetuar me shkrim.

Neni 6

Pjesëmarrja në mbledhje

1. Të gjithë anëtarët e Këshillit Shkencor janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Shkencor.
2. Anëtarët e Këshillit Shkencor votojnë personalisht dhe nuk lejohet delegimi i votës.
3. Para fillimit të mbledhjes, anëtarët e Këshillit Shkencor nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes, e cila është pjesë integrale e procesverbalit.
4. Anëtarët e Këshillit Shkencor mund të mungojnë në mbledhje për arsye të justifikuara, për të cilat janë të obliguar ta njoftojnë me kohë kryesuesin.
5. Për kryesuesin ose ndonjë anëtar të Këshillit Shkencor konsiderohet se ekziston konflikt interesi, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik dhe me Statutin e Institutit, kur veprimet apo vendimmarrja e tyre bien

- në kundërshtim me interesin publik, familjar apo profesional. Në këto raste, personi në konflikt interesi është i detyruar të largohet nga mbledhja gjatë shqyrtimit të çështjes përkatëse.
6. Në rast se kryesuesi i Këshillit Shkencor dhe sekretari shkencor, për shkak të konfliktit të interesit apo për arsye të tjera, nuk mund të marrin pjesë në mbledhje, atëherë mbledhjen e kryeson një nga anëtarët e Këshillit me të drejtë vote, i zgjedhur me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Neni 7

Fillimi i mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës

1. Kryesuesi e hap, e kryeson, e ndërpret dhe e përfundon mbledhjen.
2. Për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e Këshillit Shkencor kujdeset kryesuesi, në bashkëpunim me sekretarin shkencor të Institutit.
3. Në fillim të mbledhjes, kryesuesi verifikon ekzistencën e kuorumit, propozon rendin e ditës, hap diskutimin lidhur me të dhe konstaton miratimin e tij.
4. Kryesuesi ua jep fjalën diskutuesve, konstaton mbylljen e shqyrtimit të një çështjeje, e vendos çështjen në votim, konstaton miratimin ose refuzimin e saj, ndërmerr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së punës dhe shpall përfundimin e mbledhjes. Ai ndërmerr gjithashtu të gjitha veprimet e tjera të nevojshme për drejtimin e mbledhjes, në përputhje me këtë Rregullore.
5. Anëtarët e Këshillit Shkencor kanë të drejtë të propozojnë ndryshime apo plotësime të rendit të ditës, duke arsyetuar propozimin e tyre.
6. Materialet apo kërkesat që paraqiten gjatë mbledhjes mund të miratohen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Neni 8

Ecuria e mbledhjes

1. Pas miratimit të rendit të ditës, kalohet në shqyrtimin dhe vendimmarrjen për çështjet që përfshihen në pikat e tij.
2. Raportin dhe arsyetimin për secilën pikë të rendit të ditës e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar prej tij, në përputhje me detyrën zyrtare. Pas paraqitjes, kryesuesi hap diskutimin.
3. Të gjithë anëtarët e pranishëm të Këshillit Shkencor kanë të drejtë të marrin pjesë në diskutim dhe të paraqesin mendimet apo propozimet e tyre lidhur me çështjet në shqyrtim.
4. Fjala për diskutim jepet nga kryesuesi, sipas radhës së paraqitjes së kërkesës.
5. Pjesa hyrëse e secilës pikë, e mbajtur nga kryesuesi ose personi i autorizuar, mund të zgjasë deri në 5 minuta, diskutimet për secilën pikë kufizohen në 3 minuta, ndërkaq një anëtar mund të marrë fjalën deri në dy herë për të njëjtën çështje.
6. Askush nuk mund të diskutojë pa marrë më parë fjalën nga kryesuesi i mbledhjes.
7. Kryesuesi është përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe për mbarëvajtjen e mbledhjes, në përputhje me rendin e ditës.

8. Kryesuesi ka të drejtë t'u kërkojë folësve që të diskutojnë për temën përkatëse.
9. Kryesuesi mund ta ndërpresë përkohësisht mbledhjen, për një kohë jo më të gjatë se 30 minuta.
10. Kryesuesi ka të drejtë ta ndërpresë mbledhjen, nëse vlerëson se nuk ekzistojnë kushtet normale për zhvillimin e saj.
11. Këshilli Shkencor, me propozim të kryesuesit ose të ndonjë anëtari tjetër, mund të vendosë që shqyrtimi i disa çështjeve specifike të ndërpritet, për t'u përgatitur më hollësisht për mbledhjen e ardhshme.

Neni 9

Parashtrimi i kërkesave-ankesave

1. Çdo anëtar i Këshillit Shkencor ka të drejtë të parashtrojë kërkesa ose ankesa lidhur me temat e trajtuara nga Këshilli.
2. Kryesuesi i Këshillit Shkencor ka të drejtë të kërkojë që kërkesa ose ankesa të dorëzohet me shkrim.

Neni 10

Vendimmarrja, votimi dhe zgjedhjet

1. Mbledhjet e Këshillit Shkencor zhvillohen vetëm kur ka kuorum, që përbëhet nga shumica e anëtarëve me të drejtë vote, përkatësisht një më shumë se gjysma e tyre.
2. Vendimet e Këshillit Shkencor janë të vlefshme vetëm nëse kuorumi konfirmohet në momentin e votimit. Në rastet kur votohen çështje që i përkasin kompetencës së Këshillit Drejtues, anëtarët që janë njëkohësisht pjesë e Këshillit Drejtues nuk kanë të drejtë vote dhe nuk përfshihen në kuorum.
3. Para se të kalohet në votim, kryesuesi formulon propozimin për vendimin ose për kërkesën, sipas pikës përkatëse të rendit të ditës.
4. Pas përfundimit të diskutimeve mbi një pikë të rendit të ditës, Këshilli Shkencor merr vendim ose nxjerr konkluzion përkatës.
5. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast të barazimit të votave, në votimet e hapura, vendimtare është vota e kryesuesit.
6. Nëse ka më shumë se një propozim për vendim ose konkluzion, fillimisht votohet për propozimet që vijnë nga materialet zyrtare ose nga organet e Institutit, dhe më pas për propozimet e tjera.
7. Votimi zhvillohet në mënyrë të hapur (me ngritje dore) ose me votim të fshehtë.
8. Forma e votimit është si vijon: "Për", "Kundër", ose "Abstenim".
9. Votimi i fshehtë realizohet nga një komision i përbërë prej tre (3) anëtarësh, të cilët caktohen nga Këshilli. Dy prej tyre zgjidhen nga radhët e anëtarëve të Këshillit Shkencor, ndërsa anëtari i tretë është sekretari i Institutit, i cili merr pjesë në komision sipas detyrës zyrtare.
10. Pas përfundimit të votimit, në bazë të rezultatit të votimit, kryesuesi konstaton nëse propozimi për vendim ose konkluzion është miratuar ose refuzuar.

Neni 11

Zbatimi i procedurës së votimit të fshehtë

1. Vendimet e mëposhtme të Këshillit Shkencor merren me votim të fshehtë:
 - a. Propozimi për zgjedhjen dhe shkarkimin e drejtorit të Institutit;
 - b. Propozimi për zgjedhjen dhe shkarkimin e sekretarit shkencor;
 - c. Propozimi për caktimin e ushtruesit të detyrës së drejtorit;
 - d. Caktimi i tre anëtarëve për Këshillin Drejtues;
 - e. Çështjet që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në interesat private të ndonjërit prej anëtarëve të Këshillit Shkencor.
2. Numërimi i votave për këto çështje bëhet në praninë e anëtarëve të Këshillit Shkencor.

Neni 12

Propozimi i kandidatëve për drejtor të Institutit

1. Drejtori i Institutit zgjidhet nga Këshilli Drejtues, mbi bazën e listës së kandidatëve të propozuar nga Këshilli Shkencor.
2. Komisioni profesional, i emëruar nga Këshilli Shkencor, ka për detyrë të verifikojë nëse kandidatët e paraqitur për pozitën e drejtorit i përmbushin kushtet e përcaktuara në konkursin publik.
3. Kandidatët për drejtor të Institutit votohen nga anëtarët e Këshillit Shkencor përmes votimit të fshehtë, duke përdorur fletëvotime të përgatitura enkas për këtë qëllim.
4. Fletëvotimi përmban emrat e të gjithë kandidatëve të listës së miratuar nga Këshilli Shkencor.
5. Renditja e kandidatëve bëhet sipas numrit rendor të protokollit të aplikimit.
6. Çdo anëtar i Këshillit Shkencor ka të drejtë të rrumbullakosë vetëm një kandidat në fletëvotim.
7. Fletëvotimet që kanë të rrumbullakosur më shumë se një kandidat do të konsiderohen të pavlefshme.
8. Numri i votave të vlefshme llogaritet për secilin kandidat në mënyrë individuale.
9. Në bazë të rezultateve të votimit, Këshilli Shkencor i propozon Këshillit Drejtues kandidatët për drejtor të Institutit.

Neni 13

Propozimi i kandidatëve për ushtruesin e detyrës së drejtorit

1. Në rast se drejtori nuk zgjidhet brenda afatit të përcaktuar, detyrën e drejtorit e kryen ushtruesi i detyrës së drejtorit.

2. Kandidatët për ushtrues të detyrës së drejtorit i propozon Këshilli Shkencor, ndërsa caktimin e ushtruesit të detyrës e bën Këshilli Drejtues, me mandat deri në gjashtë (6) muaj.
3. Të drejtën e propozimit të kandidatëve e kanë të gjithë anëtarët e Këshillit Shkencor.
4. Anëtarët e Këshillit Shkencor, që plotësojnë kriteret për drejtor të Institutit, mund të propozojnë vetveten si kandidatë për ushtrues detyre.
5. Bazuar në propozimet, kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave nga Këshilli Shkencor i propozohet Këshillit Drejtues për caktimin si ushtrues i detyrës së drejtorit.

Neni 14

Propozimi i kandidatit për sekretar shkencor

1. Sekretar shkencor mund të zgjidhet punonjësi shkencor me gradën akademike doktor i shkencave albanologjike, ose punonjësi që i plotëson kushtet për t'u zgjedhur së paku në titullin bashkëpunëtor shkencor.
2. Kandidatin për sekretar shkencor e propozon Këshilli Shkencor nga radha e punonjësve shkencorë të Institutit. Zgjedhja bëhet nga Këshilli Drejtues i Institutit, me mandat 4-vjeçar. I njëjti person mund të rizgjidhet.
3. Procedurat e votimit rregullohen si më poshtë:
 - a. Kandidatët për sekretar shkencor votohen nga anëtarët e Këshillit Shkencor me votim të fshehtë, nëpërmjet fletëvotimeve të përgatitura për këtë qëllim;
 - b. Në rast se ka më shumë se një kandidat, renditja e tyre bëhet sipas renditjes së propozimit;
 - c. Fletëvotimi përmban të gjithë kandidatët e përcaktuar në listën e Këshillit Shkencor;
 - d. Secili anëtar ka të drejtë të rumbullakosë vetëm një kandidat. Fletëvotimet me më shumë se një kandidat të rumbullakosur konsiderohen të pavlefshme;
 - e. Numri total i votave numërohet për secilin kandidat.
4. Kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave të anëtarëve të Këshillit Shkencor i propozohet Këshillit Drejtues për t'u zgjedhur sekretar shkencor i Institutit.

Neni 15

Caktimi i tre anëtareve të Këshillit Drejtues

1. Tre anëtarë të Këshillit Drejtues caktohen nga radha e udhëheqësve të degëve të Institutit, të cilët zgjidhen nga Këshilli Shkencor.

2. Të pesë udhëheqësit e degëve të Institutit votohen nga anëtarët e Këshillit Shkencor me votim të fshehtë, përmes fletëvotimeve të përgatitura posaçërisht për këtë qëllim.
 - a. Fletëvotimi përmban emrat e të gjithë udhëheqësve të degëve të Institutit;
 - b. Secili anëtar i Këshillit Shkencor ka të drejtë të rrumbullakosë deri në tre kandidatë;
 - c. Fletëvotimet në të cilat janë rrumbullakosur më shumë se tre kandidatë konsiderohen të pavlefshme;
 - d. Numri total i votave për secilin kandidat numërohet në përfundim të votimit.
3. Tre udhëheqësit e degëve të Institutit, që marrin numrin më të madh të votave nga anëtarët e Këshillit Shkencor, caktohen anëtarë të Këshillit Drejtues.

Neni 16

Mbajtja e rendit në mbledhje

1. Për mbajtjen e rendit në mbledhje kujdeset kryesuesi.
2. Kryesuesi dhe pjesëmarrësit në mbledhjen e Këshillit Shkencor janë të detyruar të respektojnë dispozitat e kësaj rregulloreje.
3. Në rast të shkeljes së rendit gjatë mbledhjes, mund të merren masat disiplinore:
 - a. Vërejtje;
 - b. Marrje e fjalës;
 - c. Largim nga mbledhja.
4. Vërejtje verbale mund t'i jepet pjesëmarrësit nëse, përmes sjelljes ose diskutimit të tij, çrregullon apo pengon zhvillimin normal të punës.
5. Marrje e fjalës i shqiptohet pjesëmarrësit, i cili vazhdon të pengojë punën normale në mbledhje, edhe pse më parë i është dhënë vërejtje.
6. Masat disiplinore të vërejtjes dhe marrjes së fjalës shqiptohen nga kryesuesi i mbledhjes.
7. Largim nga mbledhja shqiptohet ndaj pjesëmarrësit që, edhe pas marrjes së fjalës, vazhdon të pengojë mbarëvajtjen e mbledhjes.
8. Masën e largimit nga mbledhja e shqipton Këshilli Shkencor, me shumicë votash.
9. Pjesëmarrësi, ndaj të cilit është marrë kjo masë, është i detyruar të largohet menjëherë nga mbledhja. Kjo masë vlen vetëm për mbledhjen përkatëse dhe nuk aplikohet për mbledhjet e ardhshme.

Neni 17

Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Shkencor

1. Në çdo mbledhje të Këshillit Shkencor hartohet procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryesuesi i mbledhjes dhe nga procesmbajtësi.
2. Procesverbali duhet të përmbajë, në mënyrë të detajuar, elementet e mëposhtme:

- a. Vendin, datën dhe orën e fillimit dhe të përfundimit të mbledhjes;
 - b. Rendin e ditës;
 - c. Listën e pjesëmarrësve dhe të atyre që mungojnë;
 - d. Të gjitha propozimet e parashtruara dhe rezultatet përkatëse të votimeve;
 - e. Shënimet thelbësore mbi rrjedhën dhe diskutimet gjatë mbledhjes;
 - f. Dokumentet shtesë që lidhen me mbledhjen, të cilat bashkëngjiten si anekse të procesverbalit.
3. Procesverbali duhet të përgatitet para mbajtjes së mbledhjes së ardhshme të Këshillit Shkencor. Ekstraktet përkatëse të tij u dërgohen anëtarëve së bashku me materialin për mbledhjen pasuese.
 4. Procesverbali i mbledhjes paraprake miratohet në mbledhjen pasuese të Këshillit Shkencor.
 5. Procesverbali, së bashku me materialet shqyrtuese të mbledhjes, ruhet në arkivin e Institutit, si dokument zyrtar afatgjatë.

Neni 18

Puna e komisioneve

1. Komisionet janë organe ndihmëse të Këshillit Shkencor.
2. Komisionet formohen nga Këshilli Shkencor, në përputhje me Statutin e Institutit dhe me këtë rregullore, dhe e mbështesin atë në shqyrtimin e çështjeve të veçanta që lidhen me veprimtarinë e tij.

Neni 19

Zbatueshmëria dhe dispozitat plotësuese

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e Këshillit Shkencor, si dhe për personat e tretë që ftohen ose angazhohen në procedurat e tij.
2. Për të gjitha çështjet që nuk janë të parashikuara në këtë rregullore, do të zbatohen:

Dispozitat e Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore Shkencore;
Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
Statuti i Institutit Albanologjik.

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 21

1. Për zbatimin e drejtë të kësaj rregulloreje është përgjegjës kryesuesi i Këshillit Shkencor.
2. Interpretimin autentik të kësaj rregulloreje e bën Këshilli Drejtues.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Drejtues i Institutit.

Neni 22

1. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen nëpërmjet së njëjtës procedurë me atë të miratimit fillestar.

Nr. 90/2

Prishtinë, më 01.10. 2025

Prof. asoc. dr. Meliza Krasniqi

U.d. e drejtoreshës së Institutit

